



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Врз основа на член 47 став 1 точка 6, а во врска со член 35 и член 36 од Законот за Народната банка на Република Македонија, („Службен весник на Република Македонија“ бр. 158/10 и 123/12) и член 101 став 2 од Законот за банките („Службен весник на Република Македонија“ бр. 67/07, 90/09, 67/10 и 26/13), Советот на Народната банка на Република Македонија донесе/Нë bazë të nenit 47, paragrafi 1, pika 6, e në lidhje me nenet 35 dhe 36 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10 dhe 123/12) dhe nenit 101, paragrafi 2 të Ligjit të Bankave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 67/07, 90/09, 67/10 dhe 26/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M

për raportim për normat e ponderuara të interesit për kreditë e dhëna dhe depozitat e pranuar

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra, forma dhe afatet për raportimin e normave të ponderuara të interesit për kreditë e dhëna dhe depozitat e pranuar nga bankat dhe kursimoret drejtuar Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).
2. Bankat dhe kursimoret dorëzojnë në Bankën Popullore të dhëna të normave të ponderuara të interesit për kreditë e dhëna dhe depozitat e marra, për qëllime të statistikave të normave të interesit.
3. Të dhënat e normave të ponderuara të interesit të pikës 2 të këtij vendimi dorëzohen në Bankën Popullore në mënyrë elektronike, çdo muaj, brenda 18 (tetëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të muajit për të cilin raportohet.
4. Bankat dhe kursimoret janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të cilat duhet të jenë identike me evidencën financiare-kontabël. Me kërkesë të Bankës Popullore, bankat dhe kursimoret janë të detyruara të dëshmojnë korrektësinë dhe vërtetësinë e raportit.
5. Guvernatori i Bankës Popullore nxjerr udhëzim me të cilin përcakton mënyrën, formën dhe formularët e raportimit të të dhënave në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

6. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, nuk do të vlejë më Vendimi për dorëzimin e të dhënave të normave të interesit të bankave për depozitat e pranuar dhe kreditë e dhëna ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 126/11).

7. Raportimi për periudhat mars, prill dhe maj 2014 të raportimit do të bëhet njëkohësisht në përputhje me Vendimin për dorëzimin e të dhënave të normave të interesit të bankave për depozitat e pranuar dhe kreditë e dhëna ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 126/11) dhe në përputhje me këtë vendim.

8. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërkaq do të zbatohet nga 1 marsi 2014.

V Nr. 02-15/XIII-1/2013
28 nëntor 2013
Shkup

Guvernatori dhe kryetari
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
